



**Komiteti Evropian
i Rajoneve**

**Komisioni për Çështjet e
Shtetësisë, Qeverisjes,
Institucionale dhe Punët e
Jashtme**

CIVEX

Ndihma financiare e BE-s në dispozicion të autoriteteve vendore dhe rajonale të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për zgjerimin e BE-së



Tabela e përmbajtjes

1 Hyrje	2
2 Instrumentet rajonale	4
3 Programet dypalëshe	10
4 Programet tematike	12
5 Pasqyra e instrumenteve financiare në dispozicion të AVR-ve sipas vendit	20
6 Banka Evropiane e Investimeve	22
7 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	26
Lista e shkurtesave	29
Lista e tabelave dhe kutive	31

Ky raport u shkrua në Qershor 2018 nga
Qendra për Kërkime Sociale dhe Ekonomike (QKSE)
(Autorët: Andrzej Dziurdzik, Katarzyna Sidło dhe Klaudia Wolniewicz-Slomka)
Ai nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Komitetit Evropian të Rajoneve.

1. Hyrje

Kjo broshurë paraqet në mënyrë të përbledhur gjithë informacionin mbi ndihmën financiare që Bashkimi Evropian (BE) vendos në dispozicion të autoriteteve vendore dhe rajonale (AVR) të vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale (si Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina [BiH], ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova*¹, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia) në formën e programeve, instrumenteve dhe mundësive të tjera financiare. Ç'është më e rëndësishmja, ajo ofron një përditësim gjithëpërfshirës të broshurës së publikuar në vitin 2014 me titull "Përdorimi i efektshëm i fondeve për autoritetet vendore dhe rajonale sipas rregullores IPA II [Instrumenti i Ndihmës Para Anëtarësimit II]" në kontekstin e rishikimit afatmesëm të IPA II-shit.

IPA mbetet mjeti kryesor me anë të të cilit BE-ja mbështet reformat e vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale për zgjerimin. Mbi bazën e mësimeve të marra nga IPA e parë (2007-2013, disa veprime janë ende në vazhdim), instrumenti IPA II (2014-2020) u ri-ideua në bashkëpunim me vendet përfituese. Rëndësi e veçantë iu kushtua procesit të programimit strategjik, pasi përmes tij shuma e caktuar prej 11.7 miliard euro gjithsej u investua në mënyrë të përqendruar në nismat e një dhe shumëvendëshe në këta sektorë: demokraci dhe qeverisje; sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore; mekanizmi për mjedisin dhe klimën; transport; energji; konkurrencë dhe inovacion; arsim, punësim dhe politika sociale; bujqësi dhe zhvillim rural; si dhe bashkëpunim ndërkufitar e rajonal. IPA II-shi është një investim për të ardhmen, si për vendet e zgjerimit ashtu edhe për vetë BE-në.

AVR-të janë një partner strategjik për BE-në procesin e gjerë të programimit strategjik, së bashku me administratat qendrore kombëtare, përgjegjëse për këtë proces nga ana e vendeve përfituese. AVR-të janë gjithashtu një grup i rëndësishëm përfituesish si të asistencës teknike (mbështetje me këshillime dhe trajnime për ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive të tyre) ashtu edhe të mbështetjes financiare të drejtpërdrejt (skemat e granteve tematike) të vëna në dispozicion përmes instrumentit.

Ky botim i broshurës është një manual që përfshin morinë e mundësive të reja të ndihmës financiare në dispozicion të AVR-ve të rajonit të zgjerimit, të krijuara qysh nga botimi i vitit 2014. Programet e krijuara apo të hapura rishtas për vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale për kërkim dhe inovacion (Horizont 2020) ose rritje ekonomike (Kryebashkiakët për rritje ekonomike) mbështesin, krah për krah me strategjinë IPA II, vendet e zgjerimit që ato të ndërmarrin reformat politike dhe ekonomike, të cilat i përgatitin për integrimin evropian dhe anëtarësimin e mundshëm në BE. Fondet e para-anëtarësimit njëkohësisht ndihmojnë BE-në të arrijë objektivat e veta në menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ndihma financiare dhe teknike është një nga mjetet më të fuqishme që mund të përdoret për të promovuar vizionin e BE-së për zhvillimin rajonal të decentralizuar e afatgjatë tek partnerët e saj. Për të ndihmuar AVR-të e vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale që të lundrojnë në mundësitë e financimit të vëna në dispozicion, për të kryer vlerësimin e nevojave të tyre, si dhe përshtatshmërinë e tyre për të marrë mbështetje në kuadrin e instrumenteve të ndryshme financiare të BE-së,

* ¹ Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet e shprehura nga Shtetet Anëtare të BE-së për statusin e Kosovës dhe është në përputhje me Rezolutën nr. 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Mendimin datë 22 korrik 2010 të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

kjo broshurë e ndan ndihmën e vënë në dispozicion në programe rajonale, dypalëshe dhe tematike (shiko tabelën 1), të cilat trajtohen në pjesët 2-4 të broshurës. Pjesa 5 përmban një pasqyrë të shkurtër të instrumenteve financiare në dispozicion të AVR-ve sipas vendit. Gjithashtu, pjesët 6-7 paraqesin mundësitë teknike dhe financiare që ofron Banka Evropiane e Investimeve (BEI) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Tabela 1

Pasqyra e instrumenteve financiare që BE-ja vendos në dispozicion të AVR-ve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për zgjerimin e BE-së

Dimensioni	Programi/ instrumenti
Rajonal	<ul style="list-style-type: none"> • Programet e bashkëpunimit ndërkufitar • Korniza e investime për Ballkanin Perëndimor (KIBP) • Pakti i Kryebashkiakëve (PKB) • Rrjeti Rajonal i Anëtarësimit për Mjedisin dhe Klimën (ECRAN) • Mekanizmi horizontal i Bashkimit Evropian/ Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (Mekanizmi Horizontal)
Dypalësh	<ul style="list-style-type: none"> • Portofoli i posaçëm për vendin - IPA II
Tematik	<ul style="list-style-type: none"> • Programi i BE-së për punësimin dhe inovacionin social (PeIS) • Evropa për qytetarët • Instrumenti evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut (IEDDNJ) • Instrumenti që kontribuon në stabilitet dhe paqe (IKSP) • Organizatat e shoqërisë civile dhe autoriteteve vendore (OSHC-AV) • Ndihmat humanitare dhe mbrojtja civile • Evropa krijuese • Erasmus+ • Horizon2020 • Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit (Sigma) • Ndihma teknike dhe shkëmbimi i informacionit (TAIEX)

2. Instrumentet rajonale

Për periudhën 2014-2020, “fondi evropian për zhvillimin rajonal” (Interreg Europe) dha 27.1 miliard euro për programet e bashkëpunimit e zhvillimit rajonal jashtë BE-së. Nga këto, 11.7 miliard euro u caktuan për 12 programe IPA të bashkëpunimit ndërkufitar, prej të cilave 242 milion euro iu dedikuan posaçërisht bashkëpunimit ndërkufitar.

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar (BNK)

“Bashkëpunimi evropian ndërkufitar” (BNK), i njohur edhe si Interreg A, është një nga mekanizmat kyç me përparësi për IPA-n, i cili mbështet bashkëpunimin mes rajoneve kufitare me të paktën dy vende të ndryshme dhe që synon të trajtojë sfidat e përbashkëta të miratuara në mënyrë reciproke për të forcuar potencialin e rritjes së qëndrueshme të rajoneve, duke intensifikuar procesin e bashkëpunimit për qëllimet e zhvillimit të përgjithshëm të BE-së dhe vendeve kandidate e kandidate potenciale. Programi është vazhdim i IPA-BNK 2007-2013 dhe i paraardhësit të tij, “programit për fqinjësinë 2004-2006”.

Objektivi gjeografik i programit IPA-BNK është tek: Bullgaria, Kroacia, Greqia, Hungaria, Italia dhe Rumania nga njëra anë, si dhe Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia nga ana tjetër.

Secili nga projektet individuale menaxhohet veçmas. Dokumentet përkatëse të projektit dhe të dhënat e kontaktit mund t'i gjeni në Tabelën 2.

Personat e kontaktit:

- Autoriteti Menaxhues i Programeve Evropiane të Bashkëpunimit Territorial
+30 2310469600 ose interreg@mou.gr

Kutia 1 Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: ish -Republika Jugosllave e Maqedonisë

**Fondi IPA “Bullgari - ish -Republika Jugosllave e Maqedonisë”
Programi i bashkëpunimit ndërkufitar 2007-2013**

Kontributi i BE: 12.1 milion euro

Përfituesit: Rajonet veri-lindore, lindore dhe jug-lindore të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë

Përshkrimi: Programi u përqendrua në përmirësimin e bashkëpunimit, integritit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të rajoneve pjesëmarrëse, në këto fusha: zhvillimi ekonomik dhe kohezioni social, përmirësimi i cilësisë së jetës dhe përmirësimi i rendimentit të administratës.

Për më tepër informacion, shiko:

http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2007-2013/crossborder/bulgaria-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-ipa-cross-border-co-operation-programme-2007-2013

Tabela 2

Financimi i BE-së për programet përkatëse IPA-BNK

Programi IPA-BNK	Financimi i BE-së	Autoritetet drejtuese/ personat e kontaktit/ dokumentet
Bullgari/ Serbi	29 milion euro	Ministria e Zhvillimit Rajonal e Republikës së Bullgarisë, Departamenti i Kufijve të Jashtëm Rruga Kiril dhe Metodiy, Nr. 17-19 1202, Sofje +359 2 9405 683 tcm_exbd@mrrb.government.bg http://www.mrrb.government.bg Dokumentet e Programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/bulgaria/2014tc16i5cb007
Bullgari/Turqi	25.2 milion euro	Ministria e Zhvillimit Rajonal e Republikës së Bullgarisë, Departamenti i Kufijve të Jashtëm Rruga Kiril dhe Metodiy, Nr. 17-19, 1202, Sofje +359 2 9405 683 tcm_exbd@mrrb.government.bg http://www.mrrb.government.bg Dokumentet e Programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/bulgaria/2014tc16i5cb005

Bullgari/ ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë	16.5 milion euro	Ministria e Zhvillimit Rajonal e Republikës së Bullgarisë, Departamenti i Kufijve të Jashtëm Rruga Kiril dhe Metodiy, Nr. 17-19, 1202, Sofje +359 2 9405 683 tcm_exbd@mrrb.government.bg http://www.mrrb.government.bg Dokumentet e programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/bulgaria/2014tc16i5cb006
Kroaci/Serbi	34.3 milion euro	Agjencia për Zhvillimin Rajonal e Republikës së Kroacisë, Drejtoria për Menaxhimin e Programeve të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Rajonal Vlaška 108 10 000 Zagreb +385 1 6447-608 info@arr.hr http://www.arr.hr Dokumentet e programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/croatia/2014tc16i5cb003
Kroaci/ Bosnje dhe Hercegovina / Mali i Zi	57.2 milion euro	Agjencia për Zhvillimin Rajonal e Republikës së Kroacisë, Drejtoria për Menaxhimin e Programeve të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Rajonal Vlaška 108 10 000 Zagreb +385 1 6447-608 info@arr.hr http://www.arr.hr Dokumentet e programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/croatia/2014tc16i5cb004
Greqi/ Shqipëri	46 milion euro	Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit e Republikës së Greqisë Leoforos Georgikis Scholis 65 GR - 57001, Selaniku +30 2310 469600 interreg@mou.gr http://www.interreg.gr Dokumentet e programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/greece/2014tc16i5cb010
Greqi/ ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë	38.7 milion euro	Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit e Republikës së Greqisë Leoforos Georgikis Scholis 65 GR - 57001, Selanik

		<p>+30 2310 469600 interreg@mou.gr http://www.interreg.gr Dokumentet e programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/greece/2014tc16i5cb009</p>
Hungari/Serbi	65.1 milion euro	<p>Zyra e Kryeministrit, Departamenti për Çështjet Ndërkombëtare Wesselényi u. 20-22 1077 Budapest +36 1 474 9269 http://www.hu-srb-ipa.com/ Dokumentet e programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/hungary/2014tc16i5cb001</p>
Itali/ Shqipëri/ Mali i Zi	78.8 milion euro	<p>Rajoni i Puglias, Departamenti i Zhvillimit Ekonomik, Inovacionit, Edukimit, Trajnimit dhe Punës, Drejtori i Zyrës së Autoritetit Drejtues Via Gobetti, 26 70125 Bari area.economia@regione.puglia.it http://www.italy.albania.montenegro.eu/ Dokumentet e Programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/italy/2014tc16i5cb008</p>
Rumani/Serbi	74.9 milion euro	<p>Autoriteti Menaxhues i Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Rumani- Republika e Serbisë, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Administratës Publike dhe Fondeve Evropiane Bd. Libertății, nr. 16, Latura Nord, Sektori 5, București, 050706 +40.372.111.309 romania-serbia@mdrt.ro http://www.romania-serbia.net Dokumentet e Programit: http://ec.europa.eu/regional_policy/en/atlas/programmes/2014-2020/romania/2014tc16i5cb002</p>

Korniza e investime për Ballkanin Perëndimor (KIBP)

Programi i “kornizës së investime për Ballkanin Perëndimor” (KIBP) mbështet zgjerimin e BE-së dhe zhvillimin ekonomik-shoqëror të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës*, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. I themeluar në vitin 2009, ai është një nismë e përbashkët e Komisionit Evropian, Bankës së Këshillit të Evropës për Zhvillim (BKiE), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Bankës Evropiane të Investimeve (BEI), Grupit të Bankës Botërore, Bankës për Zhvillim KfW, dhe një numër donatorësh dypalësh. Përmes këtij programi, ofrohet mbështetje për përgatitjen dhe ekzekutimin e investimeve me përparësi, në përputhje me strategjitë rajonale dhe kombëtare, lëvrimin e granteve (nga IPA dhe 20 donatorë dypalësh) dhe huave nga institucionet financiare pjesëmarrëse, me financim kombëtar (mekanizmi i përzier). Sektorët që mbulohen janë energjia, mjedisi, sociale, transporti, infrastruktura dixhitale, dhe nismat për zhvillimin e sektorit privat. Fondi ka në fokus projekte me ndikim rajonal dhe lidhës. Projektet e vlefshme identifikohen dhe propozohen nga vendet përfituese përmes “komitetit të tyre kombëtar të investimeve” dhe “linjës së projektit të vetëm”, dhe dorëzohen nga koordinatorët kombëtar të IPA-s në përgjigje të thirrjeve përkatëse për propozime.²

Personat e kontaktit për të marrë ndihmesë në përgatitjen e aplikimeve për grante:

IFICO

Square de Meeûs 35, Kati i II

1000 Bruksel,

Udhëheqës i ekipit belg: Falko Sellner

info@ificoord.eu

www.wbif.eu

Pakti i Kryebashkiakëve (PKB)

Paketa e BE-së për klimën dhe energjinë 2020, e miratuar në vitin 2008, nxiti Komisionin Evropian (KE) të vlerësojë dhe mbështetë përpjekjet e bëra nga AVR-të në zbatim të politikave të qëndrueshme dhe eficientës së energjisë (EE) duke miratuar nismën e Paktit të Kryebashkiakëve (PKB). PKB-ja është një lëvizje unike nga poshtë-lart me qëllim forcimin e përpjekjeve kombëtare akoma më të gjera për uljen e dyoksidit të karbonit (CO₂), e cila ka sjellë si rezultat një numër të madh projektsh vendore dhe rajonale për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe investime të gjelbra.

Dyzet e pesë AVR nga vendet e rajonit në fjalë (me përjashtim të Kosovës*) janë palë nënshkruese të konventës dhe po bëhen përpjekje për të krijuar një zyrë për Paktin e Kryebashkiakëve (ZPKB) për Evropën Juglindore.

Personat e kontaktit:

- Zyra për Paktin e Kryebashkiakëve
+32 26468424 ose info@eumayors.eu
- Zyra lindore e Paktit të Kryebashkiakëve
+38 0322553165 or info-east@eumayors.eu
- <https://www.eumayors.eu/contact/>

² Më shumë: <https://www.wbif.eu/about-the-wbif/how-to-apply-for-a-wbif-grant->

Rrjeti Rajonal i Anëtarësimit për Mjedisin dhe Klimën (ECRAN)

Rrjeti Rajonal i Anëtarësimit për Mjedisin dhe Klimën (ECRAN), i menaxhuar nga KE-ja, ndihmon vendet kandidatë dhe kandidatë potencial të shkëmbejnë përvojat dhe informacionin e tyre në lidhje me veprimet mjedisore dhe klimatike të nevojshme për anëtarësimin në BE.³ I themeluar në tetor 2013, ECRAN mbështetet në përvojën e “programit rajonal të rindërtimit mjedisor për Evropën Juglindore” (REReP) dhe të “rrjetit rajonal mjedisor për anëtarësim” (RENA). ECRAN përfshin grupe pune për mjedisin dhe klimën, si dhe një komponent horizontal që trajton shoqërinë civile, monitorimin e progresit dhe ekzekutimit, dhe zbatimin e acquis-it.

Personat e kontaktit⁴:

- znj. Joanna Fiedler-Mórotz, Drejtor i Projektit
joanna.fiedlermorotz@humandynamics.org

Mekanizmi horizontal i Bashkimit Evropian/ Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (Mekanizmi Horizontal)

Mekanizmi Horizontal është një nismë e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që synon të ofrojë asistencë teknike për autoritetet kombëtare, vendore dhe rajonale në vendet kandidatë, në mbështetje të punës së tyre për përafrimin e legjislacionit dhe politikave të tyre me standardet e BE-së. Aktivitetet strukturohen rreth tre temave: i) garantimi i drejtësisë; ii) lufta ndaj krimit ekonomik; dhe iii) lufta ndaj diskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve të cënueshme. Programi zgjat nga maji 2016 deri në maj 2019. Buxheti i tij arrin gjithsej 25 milion euro (80% e shumës vjen nga BE-ja, 20% nga KiE-ja). Financimi është në dispozicion të të gjitha vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale, përveç Turqisë, e cila gjithsesi mund të marrë ekspertizë ligjore nga KiE-ja në kuadrin e “mekanizmit të bashkërendimit të ekspertizës”.

Thirrjet për shprehje interesi publikohen në faqen e internetit të “Mekanizmit Horizontal”: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/calls-for-interest>.

Personat e kontaktit:

- Zyra e Këshillit të Evropës në Beograd
+381 117155500 ose Horizontal.Facility@coe.int

³Për më shumë, shiko: http://www.ecranetwork.org/Files/ECRAN_Brochure_2016.pdf

⁴Kujdes: adresat personale të postës elektronike mund të ndryshojnë. Për të parë listën e përditësuar të personave të kontaktit, ju lutemi të vizitoni: <http://www.ecranetwork.org/Contact>

3. Programet dypalëshe

IPA II-shi është një investim për të ardhmen, si për vendet e zgjerimit ashtu edhe për vetë BE-në. Vendet përfituese mbështeten që të ndërmarrin reformat politike dhe ekonomike që i përgatitin për integrimin evropian dhe anëtarësimin e mundshëm në BE. Fondet e para-anëtarësimit njëkohësisht ndihmojnë BE-në që të arrijë objektivat e veta në menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Tabela 3 më poshtë paraqet shpërndarjen treguese të buxhetit të përgjithshëm të IPA-s sipas vendeve.

*Tabela 3
Buxheti i përgjithshëm IPA II (2014-2020)*

Shqipëria	649.4 milion euro
Bosnje dhe Hercegovina	167.1 milion euro (përjashtuar fondin e dhënë për bashkëpunimin ndërkufitar, instrumentin e shoqërisë civile, programin e strehimit rajonal dhe masave të posaçme pas përmbytjeve të vitit 2014)
Former Yugoslav Republic of Macedonia	664.2 milion euro
Kosova*	645.5 milion euro
Mali i Zi	270.5 milion euro (përjashtuar fondit e dhënë për bashkëpunimin ndërkufitar)
Serbia	1.5 miliard euro
Turqia	4.5 miliard euro (përjashtuar fondin e dhënë për bashkëpunimin ndërkufitar)
Shumë vendëshe	Financimi i dhënë në mbështetje të shumë vendeve përfshin financime për mbështetje horizontale (si asistencë teknike dhe trajnime për autoritetet përfituesve të IPA II-shit, përmes programeve TAIEX dhe të binjakëzimit); struktura dhe rrjete rajonale; mbështetje në investime rajonale (si p.sh korniza e investimeve për Ballkanin Perëndimor); dhe bashkëpunim territorial (ndërkufitar) që arrin 2.9 miliard euro në total (përfshirë 542 milion euro fonde të pashpërndara për Bosnjën dhe Hercegovinën).

AVR-të, në secilin vend, mund të marrin informacion, për qëllime planifikimi, për aktivitetet që parashikojnë strategjia shumëvjeçare për vendin, programet vjetore të propozuara për veprim për vendin, si dhe në homologët e tyre shumëvendësh dhe sektorialë. Këto programe përcaktojnë në mënyrë të hollësishme mundësitë përkatëse për mbështetje dhe financim, të cilat më pas shpallen në secilin vend përfitues ose në një mjedis shumë-shtetësh, apo si tender (projekte të asistencës teknike) ose thirrje për propozime (skema grantesh).

Këto mund të gjenden në faqen e internetit të “Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ndërkombëtar”, në pjesën thirrje për propozime dhe shpallje për tender, e cila duhet të rishikohet rregullisht.⁵

Informacion i mëtejshëm mund të merret në çdo vend përfitues përmes Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (programimi dhe koordinimi vjetor), njërive qendrore të financimit dhe kontraktimit (shpallje për tender dhe thirrje për propozime), si dhe pranë zyrave përkatëse për integrimin në BE dhe ministritë e linjës përgjegjëse për sektorët (për AVR-të, më me rëndësi është përfshirja e ministrisë përgjegjëse për financën, zhvillimin, ekonominë, punësimin, çështjet sociale, arsimin, transportin dhe mjedisin), si dhe Delegacionet vendore të BE-së.

Personat e kontaktit⁶:

- Shqipëria
Daniela Çekani, Drejtore për Fondet e BE-së, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme daniela.cekani@mfa.gov.al
Gentian Xhaxhiu, Drejtues i Njësisë për Bashkëpunim Territorial, Drejtoria për Fondet e BE-së, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme gentian.xhaxhiu@mfa.gov.al
- Bosnje dhe Hercegovina
Edin Dilberovic, KKIPA, Drejtor i Drejtorisë për Integrimin Evropian
+387 33255044 ose edin.dilberovic@dei.gov.ba
- Kosova*
Demush Shasha, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit Evropian, Koordinator Kombëtar i IPA-s
+381 3820027029 ose demush.shasha@ks-gov.net
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Arbr Ademi, Koordinator Kombëtar i IPA-s
Arbr Ademi, National IPA Coordinator +389
23113245 ose cabinet@sep.gov.mk
- Mali i Zi
Aleksandar Andrija Pejović, Koordinator Kombëtar i IPA-s
+382 20225568 ose aleksandar.pejovic@mfa.gov.me
- Serbia
Jadranka Joksimović, Koordinatore Kombëtare e IPA-s
+381 113617580 / 593 ose kabinet@eu.rs
- Turqia
Faruk Kaymakcı, Koordinator Kombëtar i IPA-s për Turqinë
+90 3122181469 / 62 ose faruk.kaymakci@mfa.gov.tr
Beyza Turan, Drejtor për Bashkëpunim Financiar dhe Aysel Çamur
bturan@ab.gov.tr; acamur@ab.gov.tr

⁵ Për më shumë, shiko: <https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?ADSSCnck=1527497922370&do=publi.welcome>

⁶ Kujdes: adresat personale të postës elektronike mund të ndryshojnë. Për të parë listën e përditësuar të personave të kontaktit, ju lutemi të vizitoni: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/instruments/national-ipa-coordinators_en

4. Programet tematike

Programi i BE-së për punësimin dhe inovacionin social (PeIS)

Programi i BE-së për punësimin dhe inovacionin social (PeIS) është një program i ri pan-evropian për politikën sociale dhe të punësimit, i cili kombinon programet PROGRESS (programi për punësimin dhe solidaritetin social), EURES (Shërbimi Evropian për Punësimin) dhe PROGRESS Mikro-financë me qëllim nxitjen e mobilitetit në punë dhe mbështetjen me mikro-financime të sektorëve të cenueshëm të shoqërisë. Programi PeIS, i cili furnizon me të dhëna strategjinë dhjetëvjeçare të rritjes së BE-së, është në një linjë me “fondin social evropian” (FSE) dhe “fondin evropian të globalizimit” (FEG). Objektivi i tij i përgjithshëm është të intensifikojë krijimin e vendeve të punës dhe të lehtësojë rritjen e qëndrueshme duke nxitur inkurajuar risitë sociale.

Buxheti i programit për periudhën 2014-2020 është 919.5 milion euro në total, prej të cilave rreth 21% do t'i dedikohen mikro-financimit dhe sipërmarrjes sociale, 61% modernizimit të punësimit dhe politikës sociale (PROGRESS) dhe 18% për promovimin e mobilitetit në punë (EURES). AVR-të e vendeve kandidate dhe kandidate potenciale kanë të drejtë të aplikojnë për të marrë fonde nga PROGRES, mikro-financimi dhe ndërmarrjet sociale (në përputhje me kornizën e tyre përkatëse).

Personat e kontaktit:

- Serbi, Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale
Nemanjina 22-26, 11000 Belgrade, +381 113616261
- Jacqueline Breidlid, Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë (EFTA), JBR@efta.int
- EMPL-VP-2018-005@ec.europa.eu

Evropa për Qytetarët

Ky program synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve për BE-në, historinë, vlerat, diversitetin dhe proceset e saj, si dhe të nxisë dhe lehtësojë pjesëmarrjen e tyre demokratike. Çështjet me përparësi për periudhën 2018-2020 ndahen në dy fusha: kujtesa evropiane dhe angazhimi demokratik e pjesëmarrja qytetare. Përveç projekteve për shoqërinë civile, ky program mbështet edhe binjakëzimin e qyteteve dhe krijimin e rrjeteve të qyteteve. Në të mund të marrin pjesë organe publike (përfshirë AVR-të) të Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe ato të BE-së (rregulla të ndryshme aplikohen për çdo zë).⁹

Personat e kontaktit:

- Kujtesa evropiane: eacea-c1-remembrance@ec.europa.eu
- Angazhimi demokratik dhe pjesëmarrja qytetare (binjakëzimi i qyteteve dhe rrjetet e qyteteve): EACEA-C1-TT-NT@ec.europa.eu
- Operating grants: eacea-c1-operatinggrants@ec.europa.eu

⁷ Për më shumë, shiko <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1081>

⁸ Për më shumë, shiko: https://eacea.ec.europa.eu/europe-for-citizens_en

⁹ Po aty

Kutia 2 Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: Mali i Zi

Skema e granteve të BE-së për zhvillim e bashkive, skema e granteve ndërbashkiake dhe asistencë teknike

Kontributi i BE-së: 8.8 milion euro

Përfituesit: Unioni i Bashkive të Malit të Zi (UBMZ) dhe të tjerë

Përshkrim: Qëllimi kryesor i projektit ishte të ndihmonte bashkitë e Malit të Zi të kalonin në metodat e reja operative në përputhje me qasjet e BE-së. Grantet e BE-së për zhvillimin e infrastrukturës vendore janë përdorur si një mënyrë e “të mësuarit duke bërë” duke synuar që autoritetet vendore të fitojnë përvojë praktike në menaxhimin e asistencës së financuar nga BE-ja.

Ky projekt kishte në fokus njësitë e qeverisjes vendore në zonat më pak të zhvilluara të vendit për të zbutur pabarazitë rajonale dhe për të përmirësuar kapacitetin e administratave vendore për të punuar me BE-në.

Për më tepër informacion, shiko:

<http://www.delme.ec.europa.eu/code/navigate.php?Id=396>

Instrumenti evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut (IEDDNJ)

“Instrumenti evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut” (IEDDNJ) synon të ofrojë ndihmë në mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut për aktorët jo-shtetërorë (AJSH) dhe AVR-të. Buxheti për programin aktual (2014-2020) arrin në 1.3 milion euro, një rritje prej rreth 21% krahasuar me buxhetin e mëparshëm (2007-2013). Duke marrë parasysh situatën politike në Turqi, fondi i dhënë për vendin në vitin 2016 u rrit në 5 milion euro. Ndihmesa mund jetë në formën e granteve, kontratave publike, misioneve të vëzhgimit ose projekteve dhe programeve.

Personat e kontaktit:

- Për të marrë informacion rreth IEDDNJ, kontaktoni Delegacionin e BE-së në vendin tuaj.

Instrumenti që kontribuon në stabilitet dhe paqe (IKSP)

“Instrumenti që kontribuon në stabilitet dhe paqe” (IKSP)¹⁰ është një nga instrumentet kyç të ndihmës së jashtme, i cili bën të mundur që BE-ja të mbështetë projekte në fushat e reagimit ndaj krizave, parandalimit të konflikteve, forcimin e paqes dhe parapërgatitjen për tu bërë ballë krizave, si dhe për të trajtuar rreziqet globale dhe ndërrajonale. Objektivat kryesorë të programit janë: të rrisë shkallën e gatishmërisë dhe kapaciteteve të BE-së për parandalimin e konflikteve dhe forcimin e paqes në bashkëpunim me aktorë të tjerë ndërkombëtarë,

¹⁰ Për më shumë, shiko: <http://ec.europa.eu/dgs/fpi/what-we-do/instrument-contributing-to-stability-and-peace-en.htm>

kombëtarë dhe lokalë; të përmirësojë reagimin e saj ndaj krizës në rast fatkeqësish natyrore ose konfliktesh politike; dhe të rrisë kapacitetet për të trajtuar kërcënimet ndaj sigurisë globale dhe ndërrajonale, si terrorizmi, ndryshimet klimatike, pirateria dhe krimi i organizuar. Buxheti IKSP-së për periudhën 2014-2020 është 2.3 miliard euro. Pavarësisht se AVR-të e vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale kanë të drejtë të aplikojnë për të marrë financim në kuadër të IKSP-së, deri më 30 maj 2018 nuk u identifikua asnjë projekt i pranueshëm.

Personat e kontaktit

- Për të marrë informacion rreth IKSP, kontaktoni Delegacionin e BE-së në vendin tuaj.
- Kontaktoni shërbimin e instrumenteve të politikës së jashtme
+32 25841111 ose formulari i kontaktit
http://ec.europa.eu/dgs/fpi/about/contact_us_en.htm

Kutia 3 Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: Shqipëria

Nxitja e të margjinalizuarve lokalë pa stimagtizuar (FLOWS)

Kontributi i BE-së: 25,000 euro

Përfituesit: Bashkia Shijak dhe të tjerë

Përshkrim: Ky projekt i binjakëzimit të qytetit synon të shkëmbejë praktikën më të mirë të strehimit dhe përjashtimit social, kundërveprimit ndaj stigmatizimit të të tjerëve, nxitjen e vullnetarizimit dhe pjesëmarrjes qytetare, si dhe forcimin e dialogut ndërkulturor. Për më shumë informacion shiko: <https://bit.ly/2J34GR6>

Organizatat e shoqërisë civile dhe autoriteteve vendore (OSHC-AV)

Programi për organizatat e shoqërisë civile dhe autoriteteve vendore (OSHC-AV)¹² është i hapur për shoqërinë civile dhe autoritetet vendore të të gjitha vendeve, duke shkuar përtej vendeve partnere të identifikuara në instrumentin gjeografik të “instrumentit për bashkëpunim e zhvillim” (IBZH). Qëllimi kryesor i tij është të forcojë AVR-të në rolin e tyre si krijuese të hapësirave publike vendore, rritjen e qëndrueshme dhe shërbimet publike. Objektivi final është pilotimi, zhvillimi dhe zbatimi i nismave që rritin vetëdijen e qytetarëve për rolin e AVR-ve. Një buxhet prej 1.907 miliard euro është planifikuar për aspektet kryesore të programit si më poshtë: :

- Përqendrimi tek zhvillimet e OShC-AV në nivel vendi: rreth 70% e fondit të parashikuar;
- Mbështetja në tërësi e rrjeteve të OShC-ve dhe AVR-ve: rreth 15%;
- Nismat për edukim dhe ndërgjegjësim: rreth 10%; dhe
- Mbështetja e masave: rreth 5%.

Duke qenë se nuk ka tavan për portofolin e ofruar për vendin, shpërndarja e fondit bëhet në varësi të nevojave të vendit në fjalë.

¹¹ Për më shumë, shiko https://ec.europa.eu/europeaid/funding/funding-instruments-programming/funding-instruments/instrument-contributing-stability-and_en

¹² Për më shumë, shiko https://ec.europa.eu/europeaid/tags/civil-society-organisations-and-local-authorities-cso-la_en

Personat e kontaktit:

- +32 22991111 ose EuropeAid-NSA-LA@ec.europa.eu

Kutia 4 Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë

EPICURO - Partneriteti Evropian për Ripërtëritjen Urbane

Kontributi i BE: 663,812 euro

Përfituesit: Qyteti i Shkupit dhe të tjerë

Përshkrim: Qëllimi kryesor i projektit është të nxitë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe thellimin e njohurive rreth teknologjive që komunitetet vendore kanë në dispozicion, të cilat mund t'iu vinë në ndihmë AVR-ve për të monitoruar dhe menaxhuar fatkeqësitë natyrore, zbutur efektet anësore dhe për të rritur qëndrueshmërinë e komuniteteve të tyre.

Për më shumë informacion, shiko <http://www.epicurocp.eu/partners/>

Mbrojtja civile dhe ndihmat humanitare

Në kuadër të këtij programi, BE-ja ofron ndihma humanitare dhe mbrojtje civile të paanshme, neutrale e të pavarur për vendet që luftojnë me fatkeqësi dhe emergjenca humanitare. Serbia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë morën ndihma për t'iu bërë ballë nevojave të refugjatëve. Gjithashtu, në nëntor 2015, u krijua “fondi për refugjatët për Turqinë”. Deri në fund të vitit 2017, janë kontraktuar 72 projekte me vlerë 3 miliard euro në kuadër të këtij programi, për të ofruar ndihma humanitare dhe mbështetur projektet e zhvillimit për refugjatët që qëndrojnë në Turqi.

Personat e kontaktit:

- https://ec.europa.eu/echo/contact_en

¹³ Për më shumë, shiko: https://ec.europa.eu/echo/who/about-echo_en

Evropa krijuese (2014-2020)

Programi “Evropa krijuese” mbështet shkëmbimin dhe bashkëpunimin ndërkufitar në fushën e arteve (krijuese). Për të aplikuar për financim nga mundësi të ndryshme, siç janë Rrjetet Evropiane, projektet e bashkëpunimit dhe platformat evropiane, si pjesë e nënprogramit të kulturës, aplikanti duhet të punojë me partnerë nga vende të tjera pjesëmarrëse. AVR-të e vendeve kandidate dhe kandidate potenciale¹⁴ mund të marrin pjesë në të gjitha elementet e programit, përveç “fondit të garancisë”, nën fondin ndërsektorial.

Për më shumë, shiko: ¹⁵

- Shqipëri, znj. Arlinda (Kondi) Toci
+355692020506 ose arlinda.kondi@kultura.gov.al
- Bosnje dhe Hercegovina, znj. Aida Kalender
+387 66799066 ose aida.kalender@kreativnaevropa.ba
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë,
znj. Biljana Prentoska + 389 23207446
- Kosovë*, z. Valon Ibraj
+377 45385845 ose valon.ibraj@rks-gov.net
- Mali i Zi, znj. Milena Raznatovic
+382 41232583 ose milena.raznatovic@mku.gov.me
- Serbi, z. Dimitrije Tadić
+381 113398026 ose dimitrije.tadic@kultura.gov.rs

Kutia 5 Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
CreArt- Rrjeti i Qyteteve Evropiane për Krijimtarinë Artistike (botimi i dytë)

Kontributi i BE-së: 663,812 euro

Përfituesit: Qyteti i Shkupit dhe të tjerë

Përshkrim: CreArt është një rrjet i përbërë nga qytete dhe institucione kulturore publike e private të cilat punojnë së bashku për të maksimizuar kontributin e arteve pamore në shoqëri duke mbështetur artistët, industrinë e përgjithshme krijuese dhe publikun.

Për më shumë informacion, shiko:

<https://creart2-eu.org/who-we-are/>

¹⁴ Turqia doli nga programi i Evropës krijuese në vitin 2016.

¹⁵ Kujdes: adresat personale të postës elektronike mund të ndryshojnë. Për të parë listën e përditësuar të personave të kontaktit, ju lutemi të vizitoni: https://ec.europa.eu/programmes/creative-europe/contact/creative-europe-desks_en

Erasmus +: Rinia në veprim

Programi Erasmus + është programi më i madh i BE-së që mbështet aktivitetet në fushën e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit dhe gëzon një buxhet prej 14.7 miliard euro (një rritje e buxhetit me 40%). Për vendet e para-anëtarësimit, programi shërben si një mjet për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve të programit Erasmus+ dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor me anë të shkëmbimeve të rinisë, “Shërbimit Vullnetar Evropian”, trajnimit dhe rrjetëzimit. Turqia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë vendet e programit, ndërsa Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova*, Mali i Zi dhe Serbia janë vende partnere. Për grupin e fundit, në vitin 2015, u krijua “dritarja e Ballkanit Perëndimor” me një buxhet prej 3 milion euro. Për rrjedhojë, në vitin 2016, konsumi buxhetor në Ballkanin Perëndimor pas raundit të parë u rrit me 16% krahasuar me vitin 2015 dhe, gjatë kësaj periudhe, numri i aplikimeve nga rajoni u rrit gjithashtu me 64%. Subjektet e rajonit mund të marrin pjesë në program edhe si partnere në projektet e financuara për vendet e programit Erasmus+.

Personat e kontaktit:

- Shqipëria, znj. Aida Berxholi
+355 42256508 ose albania@erasmusplus.al
- Bosnje dhe Hercegovina, z. Suad Muhibic
+387 33570260 ose office@erasmusbih.com
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
+389 23109045 ose info@na.org.mk
- Kosova *, Zyra e Erasmus+
+ 381 (0) 38 609 884 ose http://erasmusplusKosovo*.org/
- Mali i Zi, znj. Vanja Drljevic
+382 20223087 ose erasmusplus@ac.me
- Serbi, znj. Marija Filipovic Ozegovic
+381 113342430 ose neo_serbia@erasmusplus.rs
- Turqia
+90 3124096000 ose bilqi@ua.gov.tr

Kutia 6 Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: Turqia

Të projektosh dialogun

Kontributi i BE: 19,000 euro

Përfituesit: Bashkia Karsiyaka dhe të tjerë

Përshkrim: Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte të lehtësonte dialogun mes të rinjve, politikëbërësve dhe ekspertëve në fushën e politikës publike në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar.

Për më tepër informacion, shiko:

<http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/projects/eplu-project-details/#project/ca78df95-c638-4408-a006-c687b1158d0d>

¹⁶ Për më shumë, shiko : http://erasmusplus.rs/wp-content/uploads/2016/11/Podrska_SALTO.pdf

¹⁷ Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova*, Mali i Zi dhe Serbia..

Horizont 2020 (2014-2020)

Horizont 2020 (H2020) është programi më i madh i BE-së për kërkimin dhe inovacionin, me rreth 80 miliard euro të vëna në dispozicion për shtatë vjet nga viti 2014 deri në 2020. Gjithashtu, këto para do të tërheqin investime private në të mbarë kontinentin. Ky stimul financiar premtan më shumë zhvillime, zbulime dhe risi botërore duke zbatuar në treg ide akademike dhe laboratorike¹⁸ Integrimi i kornizave kombëtar të kërkimit dhe inovacionit të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale, proces ky i lehtësuar dhe i intensifikuar me pjesëmarrjen në H2020, besohet të jetë një hap i domosdoshëm drejt anëtarësimit në BE. Deri në qershor të vitit 2018, janë fituar rreth 30 projekte të paraqitura nga bashkime të përkohshme që përfshijnë AVR-të e vendeve të interesit.

Personat e kontaktit¹⁹:

- Shqipëria, z. Geron Kamberi
+355 42222409 ose geron.kamberi@akti.gov.al
- Bosnje dhe Hercegovina, z. Ammar Mirascija
+387 33492597 ose ammar.mirascija@mcp.gov.ba
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, znj. Violeta Atanasovska dhe znj. Marina Nikolovska
+389 23140186 ose violeta.atanasovska@mon.gov.mk
+389 23140186 ose marina.nikolovska@mon.gov.mk
- Mali i Zi, znj. Branka Žižić
+ 382 20405331 or branka.zizic@mna.gov.me
- Serbi, dr. Viktor Nedovic
+ 381 113631755 ose viktor.nedovic@mpn.gov.rs
Dr. Slobodan Prvanovic
+381 113713000 ext. 273; +381 605271255 ose prvanovic@ipb.ac.rs
- Turqi, znj. Selda Ulutas Aydogan
+90 312 298 1790 ose selda.ulutas@tubitak.gov.tr

Kutia 7 Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: Serbia

Ne jetojmë

Kontributi i BE: 3 milion euro

Përfituesit: Qyteti Novi Sad dhe të tjerë

Përshkrim: Ky projekt synon të fuqizojë qytetarët dhe biznesin duke i ndihmuar të kapërcejnë hendekun mes miratimit të shërbimeve qeveritare të hapura dhe inovacionit duke rritur pjesëmarrjen e tyre aktive në shërbime publike të përzgjedhura në formën e aplikacioneve telefonike. Për më shumë informacion, shiko <https://www.welive.eu>

¹⁸ Për më shumë, shiko: <https://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/what-horizon-2020>

¹⁹ Kujdes: adresat personale të postës elektronike mund të ndryshojnë. Për të parë listën e përditësuar të personave të kontaktit, ju lutemi të vizitoni: http://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/support/national_contact_points.html

SIGMA

Programi “mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit” (SIGMA) është një nismë e përbashkët e BE-së dhe Organizatës për Bashkëpunim e Zhvillim Ekonomik (OBEZH), kryesisht i financuar nga BE-ja. SIGMA nisi më 1992 dhe qysh atëherë ka përvetësuar 25 vjet përvojë pune duke këshilluar vendet në tranzicion për reforma të ndryshme të politikave publike, si dhe ka krijuar marrëdhënie afatgjata me një sërë partnerësh nga brenda vendeve. SIGMA, me mbështetjen e ekspertëve të administratave publike kombëtare të BE-së, ofron mbështetje për projektet nga “profesionistët tek profesionistët” në aspektet e projektimit dhe zbatimit. Gjithashtu, ajo mbështet dhe shpesh plotëson instrumente të tjera të BE-së për ngritjen e institucioneve.²⁰ Buxheti për SIGMA-n në vendet e interesit arrin në 18.3 milion euro për periudhën 2014-2020.²¹ Pavarësisht se AVR-të e vendeve kandidate dhe kandidate potenciale kanë të drejtë të aplikojnë apo të marrin pjesë në organizimet e SIGMA-s, rishtas nuk është identifikuar asnjë projekt i vetëm me pjesëmarrjen e tyre.²²

Personat e kontaktit²³:

- Shqipëria, Bagrat Tunyan
+33 145249264 ose bagrat.tunyan@oecd.org
- Bosnje dhe Hercegovina, Primož Vehar
+33 145248358 ose primoz.vehar@oecd.org
- Kosova*, Jesper Johnson
+33 145241399 ose jesper.johnson@oecd.org
- Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mirosława Boryczka
+33 145249983 ose mirosława.boryczka@oecd.org
- Mali i Zi, Timo Ligi
+33 14524132 ose timo.ligi@oecd.org
- Serbia, Annika Uudelepp
+33 185551304 ose annika.uudelepp@oecd.org
- Turqia, Kaido Paabus
+33 18555449 ose kaido.paabus@oecd.org

TAIEX

TAIEX është instrumenti i Komisionit Evropian për asistencën teknike dhe shkëmbimin e informacionit. Ai është një mjet i nxitur nga kërkesa, i cili mbështet përafrimin, zbatimin dhe ekzekutimin e legjislacionit të BE-së, si dhe lehtëson shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira të BE-së. Që nga vitit 1996, TAIEX ndan përvojën e nëpunësve publikë të shteteve anëtare të BE-së me vendet përfituese për të mbushur hendekun e njohurive dhe për të ofruar ekspertizë të përshtatshme për trajtimin e problemeve të vendeve përfituese, pas një njoftimi të shkurtër, përmes seminareve, misioneve të ekspertëve dhe vizitave studimore.²⁴

Personat e kontaktit:

- Grupi TAIEX NEAR-Taix@ec.europa.eu

²⁰ Për më shumë, shiko <http://www.sigmaweb.org>

²¹ Për më shumë, shiko https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/pdf/financial_assistance/ipa/2014/multi-country/ipa_il_2014_031-603.02_mc_sigma.pdf

²² Për më shumë, shiko: <http://www.sigmaweb.org/countries/>

²³ Kujdes: adresat personale të postës elektronike mund të ndryshojnë. Për të parë listën e përditësuar të personave të kontaktit, ju lutemi të vizitoni: <http://www.sigmaweb.org/contactus/> <http://www.sigmaweb.org/contactus/>

²⁴ Për më shumë, shiko <http://taieux.ec.europa.eu>

5. Pasqyra e instrumenteve financiare në dispozicion të AVR-ve sipas vendit

Tabela 4:

Pasqyra e instrumenteve financiare në dispozicion të AVR-ve, të hapura për të gjitha vendet:

Instrumentet rajonale: : <ul style="list-style-type: none">• Rrjeti Rajonal i Anëtarësimit për Mjedisin dhe Klimën (ECRAN)
Instrumentet dypalëshe: <ul style="list-style-type: none">• Portofoli IPA II për vendin
Instrumentet tematike: <ul style="list-style-type: none">• Programi i BE-së për punësimin dhe inovacionin social (PeIS)• Instrumenti evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut (IEDDNJ)• Instrumenti që kontribuon në stabilitet dhe paqe (IKSP)• Organizatat e shoqërisë civile dhe autoriteteve vendore (OSHC-AV)• Ndhimat humanitare dhe mbrojtja civile• Erasmus+• Horizon2020• Sigma• TAIEX

Tabela 5:
Pasqyra e instrumenteve financiare në dispozicion të AVR-ve, të hapura për vende të përzgjedhura:

Programi	I hapur për vendet:
Programet e bashkëpunimit ndërkufitar	<ul style="list-style-type: none"> • Shqipëria • Bosnje dhe Hercegovina • Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë • Mali i Zi • Serbia • Turqia
Korniza e investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP)	<ul style="list-style-type: none"> • Shqipëria • Bosnje dhe Hercegovina • Kosova* • Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë • Mali i Zi • Serbia
Mekanizmi horizontal i Bashkimit Evropian/ Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (mekanizmi horizontal)	<ul style="list-style-type: none"> • Shqipëria • Bosnje dhe Hercegovina • Kosova* • Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë • Mali i Zi • Serbia
Pakti i Kryebashkiakëve (PKB)	<ul style="list-style-type: none"> • Shqipëria • Bosnje dhe Hercegovina • Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë • Mali i Zi • Serbia • Turqia
Evropa për Qytetarët	<ul style="list-style-type: none"> • Shqipëria • Bosnje dhe Hercegovina • Kosova • Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë • Mali i Zi • Serbia
Evropa Krijuese	<ul style="list-style-type: none"> • Shqipëria • Bosnje dhe Hercegovina • Kosova* • Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë • Mali i Zi • Serbia

6. Banka Evropiane e Investimeve

Pasqyra institucionale

BEI-ja është banka e BE-së dhe aksionarët e saj janë 28 shtetet anëtare të BE-së. E themeluar në vitin 1958, me Traktatin e Romës, BEI-ja është një partner i natyror i financimit për institucionet e BE-së dhe operon si në BE ashtu edhe në më shumë se 160 vende të tjera. Falë autonomisë financiare, kapitalit të nënshkruar në rritje të vazhdueshme dhe renditjes së saj në nivelin e kreditimit me AAA, BEI-ja mund të marrë hua në normat më të mira të mundshme. Përfitimet nga kjo rrethanë financimi iu kalohen promotorëve të projekteve përmes kushteve konkurruese të huadhënies me maturim afatgjatë, të cilat përshtaten me projektet e investimeve afatgjata të mbështetura nga BEI-ja.

BEI-ja prej shumë vitesh operon jashtë BE-së në vendet partnere që nga viti 1963. Përmes këtyre operacioneve, BEI-ja synon të mbështetë politikën e jashtme të BE-së duke i mbështetur klientët me:

- Hua dhe forma të tjera financimi;
- Qasje në mekanizmat e përzier; dhe
- Shërbime këshillimore, përfshirë asistencën teknike.

Në vitin 2017, BEI-ja nënshkroi hua me vlerë 69.9 miliard euro për të mbështetur investimet në mbarë Evropën dhe rreth e rrotull botës, gjithashtu edhe në vendet e zgjerimit. Në Ballkanin Perëndimor,²⁶ që nga viti 2007, ajo ka dhënë 7 miliard euro financime për zhvillimin ekonomik-shoqëror, duke u bërë një nga financuesit më të mëdhenj publikë. Vetëm në vitin 2017, marrëveshjet e nënshkruara në rajon arritën shumën 330 milion euro. Përveç kësaj, huatë e dhëna Turqisë në vitin 2017 arritën vlerën 506.8 milion euro (28.6 miliard euro që nga viti 2000).²⁷

Për të qasur mundësitë e financimit më afër AVR-ve dhe ndërmarrjeve të mesme e të vogla (NMV), krahas selisë qendrore në Luksemburg, BEI-ja krijoi një zyrë rajonale për Ballkanin Perëndimor, e cila bën të mundur ofrimin e një mbështetje më të mirë për klientët e saj përgjatë gjithë fazave të projektit (shiko të dhënat e kontaktit në fund të kësaj pjese).²⁸

²⁵ Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova*, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

²⁶ Për më shumë, shiko: http://www.eib.org/attachments/country/the_eib_in_the_western_balkans_en.pdf

²⁷ Për më shumë, shiko: <http://www.eib.org/projects/regions/enlargement/turkey/index.htm>

²⁸ Po aty.

Konteksti dhe objektivat e politikës

BEI-ja përqendrohet në katër fusha: inovacion, bizneset e vogla, klima dhe infrastruktura. Njëkohësisht, përvoja e analistëve financiarë, ekonomistëve, specialistëve të klimës dhe inxhinierëve të brendshëm e kombinuar me ata të komanduar siguron suksesin e projekteve të BEI-së.²⁹ Në projekte jashtë BE-së situata nuk është aspak ndryshe, pasi aty BEI-ja vepron kryesisht nën “mandatin e huadhënësit më jashtë” (MHJ), të dhënë nga BE-ja, dhe mbështet projekte që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të shteteve që kanë nënshkruar marrëveshje të ndryshme dypalëshe me BE-në. Në korrik 2014, nisi nga puna MHJ-ja e re për periudhën 2014-2020, si dhe një seri shërbimesh shtesë, për të cilat BEI-ja ka marrë vetë përsipër rrezikun, duke u përqendruar në veçanti tek investimet në sektorin privat dhe aksionin klimatik.

Që nga viti 2009, BEI-ja ka bashkëpunuar me KiE-në, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bankën e Këshillit të Evropës për Zhvillim (BKIE), në kuadrin e kornizës së investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP),³⁰ “për të intensifikuar harmonizimin dhe bashkëpunimin në investime për zhvillimin ekonomik-shoqëror të rajonit”.³¹

Për më tepër, në fund të vitit 2016, BEI-ja vuri në veprim “nismën për përtëritjen ekonomike” (NPE), e cila synon të mbështetë rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe infrastrukturave jetike, si në Ballkanin Perëndimor ashtu edhe në “Lagjen Jugore”. Aktualisht në rajonin në fjalë janë duke u zhvilluar tre projekte: një projekt prej 80 milion euro për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Beograd, një projekt prej 29.5 milion euro për mirëmbajtjen e infrastrukturës në Shqipëri dhe një linjë financimi prej 220 milion euro për NVM-të e sektorëve kyç të ekonomisë në Malin e Zi. Vendosja në veprim e NPE-së bëri që BEI-ja të rrisë financimin e parashikuar me 7.5 miliard euro për të dy rajonet, duke shtuar 6 miliard euro për periudhën 2016-2020.³²

Matja e rezultateve

BEI-ja i përzgjedh projektet e saj në bazë të 3 shtyllave: pajtueshmëria me prioritetet e BE-së; cilësia teknike dhe qëndrueshmëria ekonomike; si dhe qëndrueshmëria financiare dhe siguria e përshtatshme. Projekti dhe rrjedhimisht vlerësimi i tij duhet të jenë në përputhje me rregulloret e prokurimit dhe të mbrojtjes së mjedisit. Për të siguruar këto standarde, BEI-ja përdor metodologjinë e “matjes së rezultateve” (MeR) për projektet e saj jashtë BE-së. Këto masa janë harmonizuar më tej me ato të institucioneve të tjera financiare dhe agjencive zhvillimore me qëllim thjeshtësimin e procesit të raportimit, në rast përzierje të projekteve dhe operacioneve të tjera të bashkëfinancuara me njëra-tjetrën.

²⁹ Për më shumë, shiko: http://www.eib.org/attachments/general/the_eib_at_a_glance_en.pdf

³⁰ Për më shumë, shiko: <https://www.wbif.eu/about-the-wbif>

³¹ Për më shumë, shiko: http://www.eib.org/attachments/country/the_eib_in_the_western_balkans_en.pdf

³² Për më shumë, shiko: http://www.eib.org/attachments/country/eib_rem_annual_report_2016_en.pdf

Instrumentet financiare

Huadhënia

Dhënia e huave është veprimtaria kryesore e BEI-së dhe zë 90% të angazhimit të saj të përgjithshëm financiar. BEI vazhdon të jetë njëkohësisht e përkushtuar për të mbështetur financiarisht projektet e investimeve që paraqesin partnerët e tjerë, promotorët privatë dhe publikë, përfshirë AVR-të. Kjo reflektohet në hua që mund të jenë individuale, shumësektoriale dhe me shumë komponentë. BEI-ja ofron gjithashtu garanci (për financimin e tregtisë) dhe pjesëmarrje në kapital (fonde për investim) për të përbushur të gjitha pritshmëritë e klientit dhe partnerëve. Huatë, për investime në sektorin publik, i jepen:

- shtetit
- një autoriteti rajonal ose vendor; dhe
- një ndërmarrje apo institucioni publik.

Huatë mund t'i jepen drejtpërdrejtë ose tërthorazi autoritetit përkatës si një linjë kredie, të cilën BEI-ja e kanalizon tek AVR-të për investime në infrastrukturë, si për shembull në bashkëpunim me një ministri kombëtare ose një institucion ndërmjetës financiar lokal.

Të gjitha huatë duhet të pasqyrojnë prioritetet e BE-së dhe BEI-së. Për këtë arsye, 31% e nënshkrimeve në vitin 2017 shkuan për të mbështetur projekte që lidheshin me aksionin klimatik. Kontribuesit kryesorë në këtë veprim ishin operacionet në transportin e pastër publik urban dhe eficientë të energjisë, dhe pjesa tjetër si linja kredie. Për shembull, kohët e fundit, në prill 2018, BEI-ja nënshkroi dy hua me Bosnjën dhe Hercegovinën, duke ofruar 150 milion euro për ndërtimin e autostradës pan-evropiane (përkatësisht Korridorin VC në jug të qytetit të Mostarit dhe seksionet e autostradë në veri të qytetit të Zenicës).³³ Në të njëjtin muaj, u nënshkrua një hua prej 45 milion eurosh me Serbinë dhe Malin e Zi për të përmirësuar sistemet e tyre të kontrollit të trafikut.³⁴

Këshillimi: Asistenca evropiane për energjinë lokale (ELENA)

“Asistenca evropiane për energjinë lokale” (ELENA) është një nismë e përbashkët e KiE-së dhe BEI-së në kuadër të programit H2020. Qëllimi kryesor i saj është të ofrojë asistencë teknike në formën e granteve për aktivitete tematike rreth eficientës së energjisë, shpërndarjes së energjisë së rinovueshme dhe transportit urban. Fondet vihet në dispozicion të projekteve që kushtojnë mbi 30 milion euro (ose më pak, sipas rastit, nëse integrohen në projekte më të mëdha) dhe skema mund të mbulojë deri në 90% të kostove të pranueshme. Periudha e zbatimit të projektit nuk duhet të tejkalojë tre vjet për projektet e eficientës së energjisë, dhe katër vjet për projektet e transportit dhe mobilitetit urban. Ndihmesa është e vlefshme për AVR-të (dhe subjekte të tjera publike dhe private, të tilla si autoritetet e transportit ose operatorët e strehimit social) e Shteteve Anëtare të BE-së, si dhe të Shqipërisë, Armenisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Gjeorgjisë, Islandës, Izraelit, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Moldavisë, Norvegjisë, Serbisë, Zvicrës dhe Turqisë.

Por, deri më 30 maj 2018, AVR-të e vendeve në fjalë nuk kanë kryer asnjë projekt të financuar nga nisma ELENA.

³³ Për më shumë, shiko: <http://www.eib.org/infocentre/press/releases/all/2018/2018-110-eib-provides-eur-150m-for-pan-european-motorway-through-bosnia-and-herzegovina.htm>

³⁴ Për më shumë, shiko: <http://www.eib.org/infocentre/press/releases/all/2018/2018-107-eib-steps-up-support-for-western-balkans-in-eu-accession-process.htm>

Këshillimi: Asistenca e përbashkët për mbështetjen e projekteve në rajonet evropiane (JASPERS)

“Asistenca e përbashkët për mbështetjen e projekteve në rajonet evropiane” (JASPERS) është një ortakëri për ofrimin e asistencës teknike dhe një nismë e përbashkët e KiE-së dhe BEI-së në kuadër të politikës së BE-së për kohezionin, e vënë në punë që prej vitit 2005. Në kuadër të kësaj skeme, ofrohet asistencë teknike për projekte të mëdha, në çdo fazë të ciklit të jetës së tyre, në sektorët e rrugëve, ajrit, detar, transportit publik, mbetjeve të ngurta ujore, zhvillimit të zgjuar dhe energjisë. Për tu pranuar në këtë skemë, duhet që kostoja totale e projektit të jetë mbi 50 milion euro për projektet mjedisore, ose 75 milion euro për sektorët e tjerë (projekte më të vogla, si p.sh. në vende më të vogla, mund të mbështeten rast pas rasti). Deri në fund të vitit 2017, 652 projekte u mbështetën në kuadër të JASPERS-it me mbi 104 miliard euro (60 miliard euro në grante).³⁵

Fondet janë në dispozicion të AVR-ve të shteteve anëtare të BE-së dhe të katër vendeve të zgjerimit: ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia. Në varësi të fondeve në dispozicion dhe kërkesës, fondet e JASPERS-it mund vihet gjithashtu në dispozicion të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kosovës*.³⁶

Disa shembuj të projekteve

Rehabilitimi i pyjeve, pyllëzimi dhe kontrolli i erozionit në Turqi³⁷

Në vitin 2016, Turqia mori një hua prej 120 milion euro për të mbështetur rehabilitimin e pyjeve, pyllëzimin dhe kontrollin e erozionit në vend. Aktivitetet e financuara nga huaja synojnë të zbusin efektet e ndryshimeve klimatike dhe të kontribuojnë në menaxhimin më të mirë të burimeve natyrore në vend. Pritet që projekti, në mënyrë të tërthortë, të krijojë ndikime (eksternalitete) pozitive tek ekonomitë lokale rurale. Ai është vazhdim i projekteve të ngjashme të zhvilluara në Turqi në vitet 2011 dhe 2013.

Ndërtimi i Rrugës 6 Kijevë- Pejë në Kosovë³⁸

Në këtë projekt do të ndërtohet një seksion 30 kilometra i një autostrade me dy korsi që do të lidhë Prishtinën dhe qytetin e katërt më të madh të Kosovës, Pejën, deri më 2021. Projekti synon të përmirësojë rehatinë, shpejtësinë dhe sigurinë e udhëtimit mes dy qyteteve, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Kosovës*, ku 95% e transportit të mallrave dhe njerëzve bëhet me rrugë. BEI-ja kontribuoi me një hua prej 80 milion euro, e cila plotësoi grantet prej 3.2 milion euro të dhëna nga “korniza e investimeve për Ballkanin Perëndimor”.

Personat e kontaktit:

- për pyetje të përgjithshme: +352 4379-1 ose infodesk@eib.org
- Matteo Rivellini, Shef i Divizionit, Operacionet e Huadhënies në Ballkanin Perëndimor, Slloveni dhe Kroaci: +352 437988417 ose m.rivellini@eib.org
- Huadhënia: listat e ndërmjetësve lokalë për çdo vend <http://www.eib.org/en/products/lending/intermediated/list/index.htm>
- Zyra rajonale për Ballkanin Perëndimor: +381 113121756 ose B.BELGRADEOFFICE@eib.org

³⁵ Për më shumë, shiko: <http://www.eib.org/products/advising/jaspers/index.htm>

³⁶ Për më shumë, shiko: <http://www.eib.org/products/advising/jaspers/index.htm>

³⁷ Për më shumë, shiko: <http://www.eib.org/infocentre/press/releases/all/2016/2016-011-eur-320-million-new-eib-finance-for-climate-action-and-knowledge-economy-investments-in-turkey.htm>

³⁸ Për më shumë, shiko: http://www.eib.org/attachments/country/the_eib_in_the_western_balkans_en.pdf

7. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) u themelua për t'i ardhur në ndihmë në ndërtimit të një epoke të re pas Luftës së Ftohtë në Evropën Qendrore dhe Lindore. Qysh atëherë, ajo ka luajtur një rol historik dhe ka fituar përvojë unike në stimulimin e ndryshimeve në rajon. BERZH-i është zotuar të ecë përpara drejt "ekonomive të orientuara nga tregu dhe të promovojë nismën private dhe sipërmarrëse". Ky ka qenë një parim udhëheqës që nga krijimi i tij në fillim të viteve 1990. BERZH-i është aktiv në pothuajse 40 ekonomi, duke operuar kryesisht me anë të investimeve financiare, shërbimeve ndaj biznesit dhe përfshirjes në reformat e politikave të nivelit të lartë. Ndër produktet financiare përfshihen huatë (të drejtpërdrejta ose përmes ndërmjetësve financiarë), investimet në kapital dhe garancitë për të promovuar tregtinë.

BERZH-i operon në një gamë të gjerë industrish, infrastrukturë dhe transport. Në portofolin e larmishëm të produkteve dhe shërbimeve të BERZH-it, AVR-të e vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale për zgjerimin e BE-së janë një partner kyç i Sektorit të BERZH-it për Infrastrukturën Bashkiake dhe Mjedisore. Në këtë sektor, BERZH-i zakonisht lëvront financime për hua dhe, në bashkëpunim me donatorë ndërkombëtarë, për grante (grante për bashkëpunim teknik dhe grante për investime). Ai ka në fokus projekte që mbështetin përmirësimin e shërbimeve bashkiake në ujësjellës, kanalizime, transport publik, rrugë urbane dhe ndriçim, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, ngrohje qendrore dhe efikasitetin e energjisë. Projektet përfshijnë zgjidhje dhe objektiva strategjike për decentralizimin, hedhjen në qarkullim të lirë (komercializimin), si dhe përmirësimin e mjedisit.

Në kuadër të "nismës për biznesin e vogël", BERZH-i ndihmon bizneset e vogla e të mesme që ato të kenë mundësi të marrin këshilla për biznes. Duke qenë se zhvillimi i NVM-ve ndikon gjerësisht tek ekonomitë lokale dhe rajonale, AVR-të janë një aktor i rëndësishëm për shumë prej këtyre veprimeve, por jo përfitues të drejtpërdrejtë.

BERZH-i menaxhon programin e financuar nga BE-ja për efikasitetin e energjisë rajonale (PEER) për Ballkanin Perëndimor, i cili përfshin një komponent përmes të cilit BERZH-i ofron mbështetje për autoritetet publike për përgatitjen e projekteve për efikasitetin e energjisë të SHSHE-s (si për shembull, përfshirja e zgjidhjeve të reja për ndriçimin e rrugëve dhe çdo ndriçim tjetër publik).

Instrumenti i financimit të drejtpërdrejtë në energji të qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor ofron një fond prej 50 milion euro në formën e huave dhe operon në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci (shtet anëtar i BE-së), ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Serbi dhe Kosovë*. Ai është i hapur për NVM-të lokale dhe zhvilluese të projekteve vendore, përfshirë AVR-të, që mbështesin projekte të mesme në efikasitetin e energjisë, energjinë e rinovueshme dhe SHSHE-në (shoqëria për shërbimet e energjisë) në sektorin publik përmes huave të drejtpërdrejta (nga 1-6 milion euro për projekt), këshilla teknike falas dhe pagesa stimuluese. Për projektet e vogla dhe të mëdha janë krijuar skema të veçanta.

<http://www.wb-reep.org/eng/financing/WebSEDFE>

Shembuj të projekteve në vendet partnere

Përkrahja në fazën e hershme të projektit në Beograd³⁹

Qyteti i Beogradit nënshkroi një kontratë me BERZH-in për ofrimin e shërbimeve këshillimore, si rezultat i së cilës u ndërmor një studim për të përcaktuar parametrat teknikë dhe ekonomikë të projektit për shoqërinë e shërbimeve energjetike të qytetit për të kursyer në ndriçimin publik. Beogradi zë rreth 40% të konsumit të përgjithshëm të energjisë në Serbi, ndërsa prodhon rreth 50% të energjisë totale të saj. Së bashku me një numër nismash të tjera, mes të cilave edhe ndërtimi i tubacionit të transmetimit të ngrohjes për të transportuar ujë të nxehtë nga termocentrali në bashkinë e Obrenovacit, fqinje me Beogradin, fondi i efikasitetit të energjisë për qytetin, ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza dhe zgjidhjen e problemit të landfillit të Vinča-s, ai përbën një program të krijuar rishtas për zbatimin në praktikë të zotimit të qeverisë vendore ndaj zhvillimit të energjisë së rinovueshme, efikasitetit të energjisë, projekteve për mbrojtjen e mjedisit, dhe masave e nismave për zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike.

Sistemi i ujësjellësit të Tiranës⁴⁰

Projekti për cilësinë e ujit në Tiranë synon të ndihmojë “Ujësjellës-Kanalizime Tiranë” (UKT), ndërmarrjen e qytetit për ujësjellësin dhe kanalizimet, të sigurojë një sistem më të qëndrueshëm të furnizimit me ujë, duke arritur objektivin e saj për të siguruar furnizim me ujë për 24 orë deri në vitin 2021, dhe njëkohësisht të ulë kostot operacionale të ndërmarrjes duke shfrytëzuar gravitetin për furnizimin me ujë, në vend të sistemit të pompimit të ujërave nëntokësore me kosto të lartë.

Huaja e BERZH-it deri në 30 milion euro do të jepet me dy këste. Kësti i parë deri në 15 milion euro do të lëvrohet pas nënshkrimit dhe kësti i dytë deri në 15 milion euro do të mbetet i palëvrueshëm. Të ardhurat e këstit të parë do të përdoren për zgjerimin e kapacitetit të impiantit të trajtimit të ujit të Bovillës dhe ndërtimin e një tubacioni të ri që do të transportojë ujë nga impianti i trajtimit të ujit të Bovillës, në pjesën veri-perëndimore të qytetit të Tiranës, me anë forcës së gravitetit.

Të ardhurat e këstit të dytë do të përcaktohen në një fazë të mëvonshme, pasi të ketë përfunduar studimi i “burimeve ujore strategjike të UKT-së”. Studimi do të përcaktojë investimin me kosto më të favorshme dhe ekonomikisht të zbatueshëm për të trajtuar problemin e mungesës së ujit në Tiranë, duke vlerësuar zgjidhjet strategjike si nga këndvështrimi i kërkesës ashtu edhe i ofertës. Zgjidhjet nga këndvështrimi i ofertës mund të përfshijnë shfrytëzimin e burimeve të reja ujore, siç është Guri i Bardhë, ndërsa zgjidhjet nga këndvështrimi i kërkesës mund të përfshijnë rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit të Tiranës dhe instalimin e matësve të rrjedhës strategjike/ të presionit, ose një zgjidhje të përzier. Projekti është një nga nënprojektet e “programit për qytete të gjelbra”.

³⁹Për më shumë, shiko: <https://balkangreenenergynews.com/major-sustainable-energy-and-environmental-projects-of-serbias-capital-announced>

⁴⁰Për më shumë, shiko: <http://www.ebrd.com/work-with-us/projects/psd/grcf-ukt-tirana-water-company.html>

*Përmirësimi i ngrohjes qendrore në Banja Luka*⁴¹

BERZH-i ka dhënë hua qytetit të Banja Lukës, i cili është qendra ekonomike, financiare, politike dhe administrative e Republikës Serbe, një nga dy njësitë politike që përbëjnë Bosnjën dhe Hercegovinën. Qyteti ka një popullsi prej afro 200,000 banorë.

Huaja e pa mbuluar me garanci prej 8.347 milion euro do të përdoret për të financuar pjesëmarrjen e qytetit në kapitalin themeltar të një shoqërie të krijuar rishtas për ngrohjen qendrore dhe blerjen fillestare të lëndës për biomasë. Shoqëria “Eko Toplane” është një shoqëri e re me shumicë të zotëruar nga privatë për ngrohjen e qytetit, e cila do të ndërtojë, zotërojë dhe operojë një impiant kaldaje me biomasë, me kapacitet 49 MW, për ngrohjen qendrore të Banja Lukës. Gjithashtu, ajo do të operojë në rrjetin ekzistues të ngrohjes qendrore dhe dy impiante të vegjël kaldajash me biomasë, në pronësi të qytetit. Shoqëria zotërohet 51% nga “IEE Banja Luka”, një sponsor i sektorit privat, ndërsa pjesa tjetër e aksioneve zotërohet nga Bashkia. Kostoja e përgjithshme e parashikuar e projektit është 18.568 milion euro, përfshirë 16.4 milion euro për shpenzime për kapital (për një impiant të ri kaldaje me biomasë dhe lidhjen me rrjetin ekzistues të ngrohjes qendrore), 1.8 milion euro për kapital qarkullues (për blerjen fillestare të lëndës drusore) dhe 0.3 milion euro për bashkëpunimin teknik (për përgatitjen e planit të veprimit të Qytetit të Gjelbër).

Projekti do të ndihmojë në arritjen e qëllimeve: kalimi nga përdorimi i karburanteve të shtrenjtë dhe ndotës të mëdhenj në përdorimin e energjisë nga biomasa, nga lënda drusore, e lirë dhe më pak ndotëse në vend; prezantimi i përvojës së sektorit privat dhe efica e shërbimeve të ngrohjes qendrore; si dhe hedhja në qarkullim të lirë (komercializimi) i operacioneve financiare përmes aplikimit të tarifave për rikuperimin e kostos.

Shembuj të tjerë të kohëve të fundit të projekteve të BERZH-it në infrastrukturën bashkiake dhe mjedisore që janë në proces nënshkrimi, zhvillimi dhe/ose rishikimi

- BiH: Bosnje dhe Hercegovina ka marrë një hua prej 25 milion euro nga BERZH-i, për ta kanalizuar si huadhënie të brendshme tek një shoqëri e shërbimeve publike bashkiake të ujësjellësit dhe kanalizimeve për projektin e përmirësimit të furnizimit me ujë. <http://www.ebrd.com/work-with-us/projects/psd/grcf-sarajevo-water.html>
- Serbi: financimi i borxhit nga BERZH-i deri në 90 milion euro për një shoqëri të krijuar si partneritet publik-privat që do të operojë në mbetjet e ngurta në Beograd. <http://www.ebrd.com/work-with-us/projects/psd/belgrade-solid-waste-ppp.html>
- Turqi: Bashkia metropolitane e Izmirit ka marrë një hua prej 70 milion euro nga BERZH-i për një projekt në transportin bashkiak (metro). <http://www.ebrd.com/work-with-us/projects/psd/izmir-metro-project-ii.html>

⁴¹ Për më shumë, shiko: <http://www.ebrd.com/work-with-us/projects/psd/grcf-banja-luka-district-heating.html>

Lista e shkurtesave

BiH	Bosnje dhe Hercegovina
BNK	Bashkëpunimi ndërkufitar
BKiE	Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim
CO2	Dyoksid karboni
KiE	Këshilli i Evropës
PKB	Pakti i Kryebashkiakëve
ZPKB	Zyra e Paktit të Kryebashkiakëve
OShC-AV	Organizatat e shoqërisë civile dhe autoriteteve vendore
IBZH	Instrumenti për bashkëpunim e zhvillim
PeIS	Programi i BE-së për punësim dhe inovacion social
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
ECRAN	Rrjeti Rajonal i Anëtarësimit për Mjedisin dhe Klimën
EE	Efiçenca e energjisë
EFTA	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
FEG	Fondi evropian për globalizimin
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
IEDDNJ	Instrumenti evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut
ELENA	Asistenca evropiane për energjinë lokale
MHJ	Mandati i huadhënësit me jashtë
EPICURO	Partneriteti Evropian për Ripërtëritjen Urbane
NPE	Nisma për përtëritje ekonomike
BE	Bashkimi Evropian
EURES	Shërbimi Evropian i Punësimit
EUSAIR	Strategjia e BE-së për rajonin e Adriatikut dhe Jonit
SHSHE	Shoqëria për shërbimet e energjisë
FSE	Fondi social evropian
FLAWS	Nxitja e të marginalizuarve lokalë pa stimagtizuar
H2020	Horizont 2020
IKSP	Instrumenti që kontribuon në stabilitet dhe paqe
IPA	Instrumenti i ndihmës para-anëtarësimit
JASPERS	Ndihma e Përbashkët për Mbështetjen e Projekteve në Evropë
AVR	Autoritetet vendore dhe rajonale
KKIPA	Koordinatori Kombëtar i IPA-s
AJSH	Aktorët jo shtetërorë
OBEZH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PPP	Partneritet publik-privat
PROGRESS	Programi për punësim dhe solidaritet social

MeR	Matja e rezultateve
RENA	Rrjeti Mjedisor Rajonal për Anëtarësim
REReP	Programi Rajonal i Rindërtimit të Mjedisit për Evropën Juglindore
SIGMA	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
TAIEX	Ndihma teknike dhe shkëmbimi i informacionit
UKT	Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë
UBMZ	Unioni i Bashkive të Malit të Zi
KIBP	Korniza e investime për Ballkanin Perëndimor

Lista e tabelave dhe kutive

TABELAT

<i>Tabela 1</i>	Pasqyra e instrumenteve financiare që BE-ja vendos në dispozicion të AVR-ve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për zgjerimin e BE-së	3
<i>Tabela 2</i>	Financimi i BE-së për programet përkatëse IPA-BNK	5
<i>Tabela 3</i>	Buxheti i përgjithshëm IPA II (2014-2020)	10
<i>Tabela 4</i>	Pasqyra e instrumenteve financiare në dispozicion të AVR-ve, të hapura për të gjitha vendet	20
<i>Tabela 5</i>	Pasqyra e instrumenteve financiare në dispozicion të AVR-ve, të hapura për vende të përzgjedhura	21

KUTIZAT ME SHEMBUJ TË PROJEKTEVE TË SUKSESSHME TË FINANCUARA NË NJË VEND KANDIDAT

<i>Kutia 1</i>	Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	5
<i>Kutia 2</i>	Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: Mali i Zi	13
<i>Kutia 3</i>	Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: Shqipëria	14
<i>Kutia 4</i>	Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	15
<i>Kutia 5</i>	Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	16
<i>Kutia 6</i>	Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: Turqia	17
<i>Kutia 7</i>	Shembull i një projekti të financuar me sukses në një vend kandidat: Serbia	18

EN

ISBN 978-92-895-0970-1
doi:10.2863/557777

QG-01-18-830-ENN



Komiteti Evropian i Rajoneve

Krijuar më 1994, pas nënshkrimit të Traktatit të Mastihtit,
Komiteti Evropian i Rajoneve është asambleja e 350 përfaqësuesve rajonalë dhe
vendorë nga të gjitha 28 Shtetet Anëtare, që përfaqësojnë mbi 507 milion shtetas
evropianë.

Rue Belliard/Belliardstraat 101 | 1040 Bruxelles/Brussel | BELGIQUE/BELGIË | Tel. +32 22822211
www.cor.europa.eu | [@EU_CoR](https://twitter.com/EU_CoR) | [/european.committee.of.the.regions](https://www.facebook.com/european.committee.of.the.regions)
[/european-committee-of-the-regions](https://www.linkedin.com/company/european-committee-of-the-regions)